



Prishtinë: 29.12.2011
Kodi i ZRRE-së: V_393_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, dhe Nenin 42 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185;
- Rregullën për vënien e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
- Rregullën për vënien e çmimeve të Gjeneratorëve të Rregulluar;
- Rregullën për vënien e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Rregullën për vënien e çmimeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike;

në mbledhjen e mbajtur me datë 29 dhjetor 2011 nxori këtë:

VENDIM

Aprovohen Dokumentet:

- I. Përcaktimi i vlerës indikative të Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit
- II. Caqet indikative të Humbjeve në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.

Arsyetim

1. Vendimi bazohet në dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të vendimit, duke marr parasysh procesin e konsultimit publik dhe shqyrtimin e komenteve të palëve të interesit të lëshuara dhe të publikuara në ueb faqen e ZRRE-së.
2. Vlerat e paraqitura në këto dokumente janë vlera indikative dhe mund të ndryshojnë gjatë procesit të shqyrtimit tarifor.
3. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të përkthimeve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare e saj.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (30) ditëve, nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

SHTOJCË:

1. Përcaktimi i vlerës indikative të Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit; dhe
2. Caqet indikative të Humbjeve në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Enver Halimi, anëtar